



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republikof Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA

Pranimi - Pranimi i Komunitetit 31-10-2024			
Nr. Dokument Org. Bëq.	Nr. Dokument	Nr. Dokument	Vlera Vrednost
01-	110/05-		1259



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2, pika d të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.Qershor 2008), të nenit 90, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.22, datë: 19. Tetor 2011), të nenit 12, paragrafi 1.6 i Rregullores (QRK) - Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, raporti i vlerësimit për dëmet e shkaktuara në bujqësi me nr. të protokollit 10-052/01-1221, i datës 22.10.2024, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më datën 31.10.2024 miraton këtë:

V E N D I M

mbi miratimin e raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton raportin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë.

Neni 2

Raportin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë, i punuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe dëme të tjera në Komunën e Vitisë.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në bujqësi me Nr. të protokollit 10-052/01-1221, i datës 22.10.2024, së bashku me listën përmbledhëse të vlerësuar nga komisioni komunal për vitin 2024.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Pranuar / Prilajeno Me Data 22-10-2024			
No. Kompartit Kom. No.	Numri i Kom. Kom. No.	Vitet e Pranuar	Vlera Vendosur
10-	052	101-	1221

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti

Datë	21.10.2024
REFERENCË	
PËR/ZA/TO:	Kuvendi Komunal të Vitisë
Përmes/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
Nga:	Komisioni komunal për vlersimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe dëmet tjera
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i vlersimit për dëmet e shkaktuara në bujqësi


Në bazë të vendimit me nr. Protokoli 02-035/02-1198 të dates 17.10.2024 nga Kryetari i Komunës për vlersimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe dëmet tjera Komisioni ka hartuar:


Raport


Pas reshjeve të breshërit të muajit qershor korrik, gushtë dhe erëra të forta të muajit shtator, në kulturat bujqësore dhe serra janë shkaktuar dëme të konsiderushme. Ne si drejtori kemi pranuar 33 kërkesa nga fermerët, nga të cilat 7 (shtatë) kërkesa janë refuzuar, 4 (katër) kërkesa janë për policinë dhe 1 (një) kërkesë është ceduar. Si komision kemi dalur tek këta fermerë në parcelat e tyre të dëmtuara për të pare gjendjen faktike dhe kemi marrë foto në vendin e ngjarjes, Komisioni ka bërë vlersimin për kulturat e dëmtuara dhe 21 kërkesa janë shqyrtuar pozitivisht. Rendimenti dhe çmimi për secilën kulturë është përcaktuar nga MBPZHR, kurse ne kemi përcaktuar vetë përqindjen (%) e dëmit. Për secilin fermer janë bërë raportet individuale financiare dhe proqesverbali. Vlera e përgjithshme e dëmit është **31113.43€**. Kerkojm nga Kuvendi Komunal i Vitise që ne seancen e radhës të miraton raportin me listën e vlersimit të dëmeve


Komisioni Komunal për vlersimin e dëmeve;


1. Sami Demelezi - Kryetar i komisionit
2. Xhelal Musa - anëtar,
3. Avni Misini - anëtar,
4. Fitim Selmani - anëtar,
5. Arta Muharremi - anëtar.











18	Xhelal Halabaku	Pozhoran	Viti	1012475272	Korrik	Breshëri	Misër Kunguj Mollë Kumbull Pjepër	10 0.5 3 1 0.3	4290 8550 12120 5090 12800	42900.00 4275.00 36360.00 5090.00 3840.00	20% 20% 20% 20% 35%	8580.00 855.00 7272.00 1018.00 1344.00	0.24 0.16 0.44 0.81 0.56	2059.20 136.80 3199.68 824.58 752.64	6972.90
19	Arbnora Pira	Pozhoran	Viti	2013217427	Korrik	Breshëri	Fasule	2.61	1840	4802.40	20%	960.48	2.38	2285.94	
20	Nazmi Pira	Pozhoran	Viti	1172639590	Korrik	Breshëri	Misër Fasule	1.78 3.87	4290 1840	7636.20 7120.80	20% 20%	1527.24 1424.16	0.24 2.38	366.54 3389.50	3756.04
21	Alie Qosaj	Sllatinë e Ep	Viti	1006068738	Shtator	Era	Foli	0.060	190.15		100%	190.15	5.30	1007.80	
Vlera totale														31113.43	

Drejtori I Bujqësisë
Naim Pira



Kryetari I Komunës
Sokol Haliti

